VENDIM
Nr.411, datë 19.5.2010

PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE TIPIN E FORMULARIT TË LEJES SË LEGALIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) lëshon lejen e legalizimit, për objektin /shtesën pa leje në ndërtime me leje, kur:

a) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është kryer vetëdeklarimi vullnetar brenda afatit ligjor;

b) objekti/shtesa pa leje në ndërtime me leje nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar;

c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar;

ç) subjekti posedues ka shlyer pagesat e parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të vendimit nr.1180, datë 3.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit dhe mbledhjen e administrimin e të adhurave të procesit të legalizimit", të ndryshuar.

2. Procedurat e pajisjes me leje legalizimi, për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje, të kualifikuara për legalizim, kryhen nga ALUIZNI.

3. Drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve, pas kualifikimit për legalizim të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Publikojnë në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit, listën e poseduesve të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, që kualifikohen për legalizim.

b) Hartojnë dokumentacionin teknik (genplan, planimetritë dhe fragmentin e fotografisë ajrore dixhitale).

c) Përllogarisin detyrimet financiare të objektit informal/shtesës pa leje në ndërtime me leje, që legalizohet, dhe njoftojnë poseduesit për shlyerjen e tyre.

ç) Pranojnë nga subjekti i interesuar dokumentacionin e përcaktuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

d) Lidhin kontratën e kalimit të së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore, nga shteti te poseduesi i objektit informal/shtesës pa leje në ndërtim me leje, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

dh) Përcjellin pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t, dokumentacionin e objektit informal/shtesës pa leje në ndërtim me leje, për kryerjen e procedurave të certifikimit.

4. Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t kontrollon dhe certifikon dokumentacionin e dërguar nga drejtoritë pranë qarqeve, plotëson procesverbalin e certifikimit dhe lëshon lejen e legalizimit, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje.

5. Leja e legalizimit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, dërgohen pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nga drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve.

6. Për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje, që përjashtohen nga procesi i legalizimit, drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve, i dërgojnë njoftim me shkrim poseduesve të tyre, si dhe organeve të njësive të qeverisjes vendore, ku këto objekte gjenden.

7. Formulari TIP i lejes së legalizimit është sipas modelit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Vendimi nr.871, datë 27.12.2006 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NR. SERIAL: 180 000 000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E LEGALIZIMIT URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t .....

LEJE LEGALIZIMI

Nr. _____ datë ___/___/ 200_

BAZUAR NË LIGJIN NR. 9482, DATË 03.04.2006
"PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE"

PËR OBJEKTIN : _____

I JEPET: _____
Emri *Atësia* *Mbiemri*

_____
Emri *Atësia* *Mbiemri*

_____
Emri *Atësia* *Mbiemri*

ME ADRESË : _____

Në ☐ zonën / ☐ vendbanimin / ☐ bllok banimin / ☐ ndërtimin informal / ☐ territore të tjera,
e emërtuar ..... me Vendimin e K.RR.T.-së/ K.RR.T.R.SH.-së. Nr._____, datë ___/___/200_ .

TË DHËNAT E OBJEKTIT: ZONA KADASTRALE _____ NR.PASURISË_____

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore: _____ m^2

Sipërfaqja e ndërtimit: _____ m^2

Sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim _____ m^2 **/ për aktivitet** _____ m^2

Numri i kateve: mbi tokë _____; **nën tokë** _____

Kondicione të veçanta: _____

KUFITARËT E PRONËS:

Veriu: _____
Jugu: _____
Lindja: _____
Perëndimi: _____

TË DHËNAT E MËSIPËRME JANË SIPAS GEN-PLANIT DHE PLANIMETRIVE BASHKËNGJITUR.

TITULLI I PRONËSISË MBI TOKËN I VËRTETUAR ME DOKUMENTIN:

_____

_____

_____

Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit **Drejtori**

_____ _____

KY DOKUMENT PLOTËSOHET NË TRE KOPJE DHE SË BASHKU ME GEN PLANIN DHE PLANIMETRITË E OBJEKTIT. ËSHTË I VLEFSHËM PËR REGJISTRIM NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME.